REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 01.12.2022)***

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 10:21.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
7. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
8. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

***Shënim***: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***; anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Brikena Ukperaj***; anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Klodian Kurushi***.

Merrnin pjesë gjithashtu në sallë dhe nëpërmjet platformës:

***1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Staf administrativ i KLGJ-së.***

***3. Denisa Varfi dhe Entela Haxhiraj (Dobi), Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.***

***4. Të tjerë: Prof. Asoc. Dr. Edit Bregu (Fakulteti i Drejtësisë); Edmond Hoxhaj (BIRN); Petrika Thano (gazetar).***

**RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 3/2022, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës", i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Marçela Shehu).

***Ilir Rusi***: Mirëmëngjesi të nderuar anëtarë!

Sipas njoftimit të bërë kohë më parë, dhe për shkak të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 01.12.2022, ora 10:00.

Sikundër jeni njoftuar, sot kemi shqyrtimin e projektvendimit "Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 3/2022, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës".

Për këtë rend dite është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni Disiplinor, të cilin do ta relatojë znj. Shehu. Për më tej, fjalën e ka zonja Shehu.

***Marçela Shehu***: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. {...} prot., datë 23.11.2022 është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 101, pika 1, shkronja "b" dhe neni 101, pika 1,

shkronja “dh” e Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin”, të ndryshuar, si dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” e këtij ligji.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistratit z. {...}, të masës disiplinore “Pezullim nga detyra”, për një periudhë deri në dy vjet, masë kjo e parashikuar nga neni 110 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në kushtet kur kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor, inicion një procedurë individuale administrative në Këshill, e cila ka lidhje me statusin profesional të magjistratit z. {...}, në referim të nenit 63 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit. Relator do të caktohet njëri nga anëtarët e Komisionit Disiplinor.

Menjëherë pas caktimit me short të relatorit, nga Këshilli duhet të procedohet me caktimin e mbledhjes plenare të radhës, në të cilën Këshilli, mbi relacionin e përgatitur nga relatori, mund të vendosë mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore, sipas nenit 139 të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve”, ose caktimin e datës së seancës dëgjimore sipas nenit 138/2 të këtij ligji.

Bazuar sa më sipër, bazuar në nenin 63 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 138 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 16 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, Komisioni Disiplinor i propozon mbledhjes plenare, zhvillimin e procedurës për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 03/2022, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Relacioni shoqërohet edhe me projektvendimin përkatës.

***Ilir Rusi***: Faleminderit zonja Shehu!

Ftoj administratën për përgatitjen dhe hedhjen e shortit përkatës.

<u>Procedura e shortit si vijon</u>:

Në vazon e qelqit futen një nga një shiritat e letrës me emrat e tre relatorëve (anëtarë të Komisionit Disiplinor): 1. Z. Ilir Rusi; 2. Z. Ridvan Hado; 3. Znj. Marçela Shehu.

Procedura e përzgjedhjes së relatorit si vijon:

Relator për procedimit disiplinor nr. 3/2022, përzgjidhet z. Ridvan Hado.

***Ilir Rusi***: Faleminderit!

Atëherë, sipas shortit, relator për çështjen në fjalë do të jetë zoti Ridvan Hado.

Ftoj anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të votuar projektvendimin "Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 3/2022, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës".

***Irena Plaku***: Pro.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Ilir Rusi***: Dakord.

Vendim "Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 3/2022, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, pasi shqyrtoi materialet e çështjes, relacionin e përgatitur, pas shortit të hedhur, vendosi:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Ridvan Hado në cilësinë e relatorit të procedimit disiplinor nr. 3/2022, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit!

*  *  *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**